



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT GJENERAL/KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA  
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. i Dok: 20.2.1-2007-08**

**RAPORTI PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
ZYRËS SË PRESIDENTIT TË KOSOVËS PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 Dhjetor 2007**

**Prishtinë, Prill 2008**

## LETËR PËRCJELLËSE

Data: 10.09.2008

### Zyra e Presidentit të Kosovës

Presidentit të Kosovës  
Sekretarit të përhershëm i ZP

Të nderuar: Zotërinj

Me këtë ju paraqesim raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit për vitin 2007 të kryera nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP).

Sipas Ligjit Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës – raportet e auditimit duhet të bëhen publike nga Auditori i Përgjithshëm.

Bazuar në nenin 3.3 (e) të Ligjit Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm- brenda 30 ditëve pas publikimit të raportit përkatës të auditimit, institucioni ose subjekti i audituar duhet t'i dorëzojë Auditorit të Përgjithshëm një raport i cili i përcakton masat të cilat institucioni ose subjekti ka për qëllim t'i ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportin e auditimit.

Dita e dorëzimit të raportit të auditimit tek ju konsiderohet bërje publike e raportit, prandaj planin e implementimit të rekomandimeve duhet t'ia dorëzoni ZAP jo më vonë se nga data 10.10 .2008 .

Me respekt.

Serafim Sofroniev  
Zëvendës Auditor i Përgjithshëm

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Qasja e auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
  - Pasqyrat Financiare
  - Shpenzimet
  - Shpenzimet telefonike
  - Pagesat për udhëtim
  - Prokurimi
  - Auditimi i Brendshëm
  - Menaxhimi i Pasurisë
- VIII. Komentet e Zyrës së Presidentit

### Aneksi 1.

- I. Pasqyrat financiare të ZPK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007

## **LISTA E SHKURTESAVE DHE FJALËVE**

AGJ	Auditori/ja Gjeneral
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
LMFPP	Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UA	Udhëzim Administrativ
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
ZPK	Zyra e Presidentit të Kosovës

## **I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës (ZPK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007. Në mendimin tonë, pasqyrat financiare nuk paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të ZPK-së, në të gjitha aspektet materiale, dhe rezultateve të aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik sipas “Raportimit Financiar të bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme”.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) dhe përfshinë testimet dhe procedurat e tilla që ne i kemi konsideruar të domosdoshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë ka identifikuar këto të gjetura kryesore të auditimit:

- Pasqyrat financiare nuk janë përgatitur sipas regjistrave kontabël të ZPK-së, por janë përgatitur duke përdorur të dhënat nga Sistemi “Free Balance” i Thesarit;
- ZPK nuk harmonizon regjistrat e saj kontabël me të dhënat financiare të Free Balansit;
- Shpenzime të tepruara për telefona
- Avanset për udhëtim nuk janë mbyllur me kohë
- Moszbatimi i Ligjit mbi Prokurimin Publik është i shtrirë gjerësisht
- Auditimi i brendshëm duhet të përqendrohet në fushat me rrezikshmëri të lartë
- Menaxhimi i pasurisë nuk bëhet sipas UA 2005/11 të nxjerr nga Departamenti i Thesarit

## **II. HYRJE**

Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) të Kosovës është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/18 të datës 4 tetor 2002. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje Auditori Gjeneral (AGJ), ndër të tjera, është i thirrur që ta kryejë auditimin vjetor të rregullsisë për të gjitha institucionet në Kosovë qoftë për ato në pronësi publike apo për ato që marrin mjete financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendë, apo të hyra të tjera jo tatimore për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Neni 1 i kësaj rregulloreje përkufizon auditimin e rregullsisë si verifikim i përgjegjësisë financiare duke përfshirë ekzaminim dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe shprehjen e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe korrekte të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të marra nga institucioni ose subjekti që iu është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo lidhen me auditimin;

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës ka miratuar “Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” Nr. 2003/2 (LMFPP), i cili edhe formalisht është shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003. Neni 42 i këtij ligji thekson që AGJ duhet të përgatisë dhe t’i dorëzoj Kuvendit dhe PSSP-së një raport lidhur me pasqyrat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar, ku AGJ jep opinionin e saj nëse pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të financave të organizatave të tilla buxhetore.

Ky raport duhet të dorëzohet më 30 qershor duke pasuar përfundimin e vitit fiskal të cilit i referohet raporti vjetor.

## **III. GJENDJA LIDHUR ME REKOMANDIMET NGA VITI I KALUAR**

Raporti i auditimit i ZAGJ-së për pasqyrat financiare të ZPK-së për vitin e mbaruar më 31 Dhjetor 2006 përmbante 10 rekomandime audituese. Auditimi ynë i tanishëm kishte vërtetuar se ZPK nuk kishte zbatuar 4 prej tyre, që kishin të bënin me:

1. Sigurimin e respektimit të procedurave të prokurimit;
2. Kompletimin e dosjeve të prokurimit;
3. Menaxhimin e Pasurisë në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2005/11 – Regjistrimi i Pasurisë Qeveritare; dhe
4. Forcimi i Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

Si rezultat i këtij mos-zbatimi të rekomandimeve tona, ne vazhdojmë të raportojmë probleme në këto katër fusha.

#### **IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT**

ZAGJ ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës (ZPK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007. Objektivë primare e këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAGJ-së të shprehë opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të ZPK-së, të paraqitura në aneksin 1, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për shpenzimet e paguara gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2007 dhe nëse këto pasqyra janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi "Rraportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) është përgjegjës për lëshimin e SNKSP-ve.

Saktësia dhe plotësia e pasqyrave fiannciare dhe shkresave shoqëruese të dhëna në Aneksin 1, janë përgjegjësi e menaxhmentit të ZPK-së.

#### **V. OPINIONI I AUDITIMIT**

Auditimi ka identifikuar mangësi serioze për sa i takon kontrolleve të brendshme të ZPK-së dhe ka përcaktuar se nuk do të mund të mbështeteshim në këto kontrolle. Në disa raste, ZPK nuk kishte zbatuar ligjet dhe rregulloret e aplikueshme, duke ndikuar kështu edhe më tej në mënyrë negative në drejtësinë, vërtetësinë dhe plotësinë e pasqyrave financiare.

Në mendimin tonë, duke u nisur nga ajo çfarë u tha më lartë, ne nuk besojmë që pasqyrat financiare të prezantuara nga ZPK paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të ZPK-së më 31 Dhjetor 2007.

#### **VI. QASJA E AUDITIMIT**

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të ZPK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007 është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të lëshuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Bordi funksionon si një organ përcaktues për standardet ndërkombëtare, nën patronazhin e FNK-së. SNA-të vendosin kornizën ndërkombëtare në kuadër të së cilës ZAGJ kryen aktivitetin e saj dhe mbulon çështje si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësime të rrezikut dhe përgjigjet ndaj rreziqeve

të vlerësuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve si dhe konkluzionet dhe raportimi mbi auditimin.

Auditimi ynë është planifikuar dhe kryer gjatë periudhës 10 mars deri 22 prill 2008.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve tona, ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të ZPK-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të ZPK-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka mundësi të kenë ekzistuar informata shtesë, të cilat nuk na janë siguruar neve, të cilat po të na siguroheshin do të kishin mundur të ndryshonin të gjeturat tona të auditimit.

Për sa i përket opinionit të auditimit të ZAGJ-së lidhur me pasqyrat financiare të ZPK-së, SNA definon kriteret specifike të cilat përcaktojnë llojin e opinionit i cili mund të epet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një opinion të pakualifikuar kur ekzistojnë cilado prej rrethanave vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ-së efekti i çështjes është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara nën (a) mund të shpijnë në opinionin e kualifikuar ose në mohimin e opinionit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpijnë në opinionin e kualifikuar ose në opinionin kundërt.



Një opinion i kualifikuar në përgjithësi lëshohet atëherë kur ZAGJ konstaton se nuk mund të jepet një opinion i pakualifikuar, por se efekti i ndonjë mosmarrëveshje me menaxhmentin ose kufizimi i fushëveprimit nuk është aq material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një opinionit të kundërt ose mohim të opinionit.

Mohim i opinionit do të epet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimisht nuk mund të lëshoj opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Një opinion i kundërt do të epet atëherë kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar ose jo të plotë të pasqyrave financiare.

## **VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KRYESORE**

Më poshtë kemi paraqitur të gjeturat dhe rekomandimet kryesore, si rezultat i auditimit tonë për pasqyrat financiare të ZPK-së.

### **1. Pasqyrat Financiare**

Departamenti i Thesarit në MEF e ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 2007/8 Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore, për entitetet të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Ky udhëzim obligon të gjitha entitetet që financohen nga BKK-ja, të dorëzojnë një raport financiar për shpenzimet e bëra nga paraja dhe mbi të hyrat, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Afati i parashikuar për të dorëzuar këtë raport në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa ishte 31 janar 2008.

Ne kemi planifikuar auditimin tonë për të vërtetuar nëse pasqyrat financiare të ZPK-së për vitin 2007 janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2007/8.

Ne kemi konstatuar se kjo nuk ka ndodhur, pasi që pasqyrat financiare për vitin 2007 nuk bazohen në regjistrat kontabël të ZPK-së, por se janë përpiluar duke përdorur informacionet e nxjerra nga të dhënat e Free Balancit të Thesarit.

ZAGJ konsideron se kjo praktikë nuk është në pajtim me Udhëzimin Administrativ të lartpërmendur i cili kërkon që pasqyrat financiare të përgatiten duke u bazuar në llogaritë e Organizatës Buxhetore.

### **Konkluzioni**

Pasqyrat financiare nuk janë përgatitur nga shënimet e kontabilitetit të ZPK, por janë përgatitur nga të dhënat e nxjerra nga Free balance.

## Rekomandimi Nr. 1

ZPK duhet të përgatisë pasqyrat e veta financiare vjetore, në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të Thesarit.

## 2. Shpenzimet

Gjatë krahasimit të regjistrave kontabël të ZPK-së me të dhënat financiare të sistemit Free Balance të Thesarit, kemi gjetur diferenca domethënëse në mes të këtyre dyjave. Në përgjithësi, kemi gjetur se ka pasur diferenca në 24 kode ekonomike. Tabela vijuese ilustron disa nga këto diferenca.

Përshkrimi i kodeve	Kodi ekonomik	Sipas kontabilitetit të ZPK-së (A)	Sipas thesarit (Free Balance) (B)	Diferenca C = (A-B)
Shpenzime udhëtimit jashtë vendit	13140	33,709.84	116,815.04	-83,105.20
Shpenzime për telefoninë fikse	13250	32,137.82	29,051.43	3,086.39
Shpenzime të telefoninë mobile	13320	59,556.92	63,618.91	-4,061.99
Furnizim me pajisje-kompjuterë	13503	5,350.97	1,631.00	3,719.97
Furnizim për zyre kompjuter	13553	7,525.40	9,745.40	-2,220.00
Rimbushje e parasë së imët	13600	6,936.83	0	6,936.83
Furnizim për zyre	13610	50,633.21	56,091.19	-5,457.98
Furnizim me ushqim dhe pije	13620	21,123.00	23,685.81	-2,562.81
Mbyllje e avanseve	13660	0	8,771.70	-8,771.70
Mbyllje e avansit	13670	0	2,107.20	-2,107.20
Avans për parat e imëta	13810	2,500.00	0	2,500.00
Avans për udhëtime zyrtare	13820	145,091.00	2,988.30	142,102.70
Mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve	14010	62,885.84	108,706.34	-45,820.50

Këto diferenca janë si rezultat i keq postimeve në kode ekonomike dhe ofrojnë dëshmi shtesë se pasqyrat financiare të ZPK-së nuk janë përgatitur bazuar në regjistrat kontabël të ZPK-së. Po ashtu është e qartë se nuk janë kryer harmonizime në mes të ZPK-së dhe të dhënave të Thesarit.

### Konkluzioni

Keq-postim i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike, dhe mos harmonizim i librave të kontabilitetit të ZPK me Thesarin.

## Rekomandimi Nr. 2

ZPK duhet që çdo muaj të harmonizoj regjistrat e saj kontabël me të dhënat financiare të Sistemit të Free Balancit dhe të zgjidhë çdo diferencë.

### 3. Shpenzimet Telefonike

Në vitin 2007, ZPK kishte bërë shpenzimet vijuese telefonike:

Telefoninë fikse	€32,137.82
Telefoninë mobile-roaming	24,879.42
Mbushje për telefona	34,435.00
<b>Totali</b>	<b>€91,452.24</b>

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2006 përcakton limitet për shpenzime për telefona fiks dhe ata mobil, varësisht prej pozitës së të punësuarit. Për shembull, sekretarit permanent i ndahen 70 Euro në muaj, për telefon fiks dhe 100 Euro në muaj për telefon mobil. Një shërbyesi civil i ndahen 10 Euro në muaj për telefonin fiks ndërsa Drejtori merr 30 Euro në muaj për telefonin mobil.

Ne kemi gjetur se ZPK nuk kishte vendosur procedura për të siguruar që shpenzimet e saja të telefonit, ishin të kontrolluara në mënyrë adekuate. Rrjedhimisht, ZPK kishte bërë shpenzime të paarsyeshme telefonike.

Për shembull, ZPK ka një personel prej 52 anëtarësh. Nëse merret një vlerë e moderuar prej 75 Euro në muaj, si shumë mesatare e shpenzime telefonike për një të punësuar (për të dy shërbimet, fikse dhe atë mobile-për roaming), ne mund të ekstra polojmë se shuma totale vjetore e shpenzimeve telefonike duhet të jetë afërsisht 46,800, € ose për afërsisht gjysma e shpenzimeve të ndodhura në 2007. Në fund, ne raportojmë se 14 nga 23 të punësuar, të cilëve u ishte siguruar numër celular me shërbime raomingu, kanë vazhduar të marrin po ashtu kartela rimbushëse, që është në kundërtënie të drejtpërdrejtë me kërkesat e Udhëzimit Administrativ.

#### **Konkluzion**

ZPK nuk ka rregullore të brendshme për shpenzime telefonike dhe menaxhmenti nuk i ka mbikëqyrur si duhet këto shpenzime. ZPK nuk ka zbatuar me përpikëri kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2006 “unifikimi i tarifave për telefona fiks dhe mobil” dhe si rezultat kishte rritur ekspozimin ndaj rrezikut të mashtrimit, humbjes dhe shpërdorimit të fondeve publike.

#### **Rekomandimi Nr. 3**

ZPK duhet menjëherë të themeloj procedura dhe kontrole adekuate për të menaxhuar shpenzimet telefonike.

ZPK duhet menjëherë të zbatoj në tërësi kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2006 që vendos kontrollet e pritura për monitorimin shfrytëzimin e telefonave, duke siguruar që të punësuarit nuk i tejkalojnë shumat e përcaktuara si prag dhe të kufizojnë shpërndarjen e

kartelave rimbushëse në mënyrë që ato të jepen vetëm për të punësuarit e autorizuar për ti marrë ato.

#### 4. Avanset për Udhëtim

Gjatë vitit 2007, ZPK kishte paguar 21 avanse (avanse udhëtimi) që arrinin vlerën e përgjithshme 105,033 €. Nga kjo shumë, për afërsisht 3,000 € kishin mbetur të pambyllura në fund të vitit.

Rregullorja e Thesarit kërkon që avanset të mbyllen deri në fund të vitit.

Për ta ilustruar më mirë, një i punësuar i ZPK-së kishte pranuar një avans për udhëtim prej 944 € për një udhëtim në Belgjikë në Shtator 2007. Ky udhëtim ishte kryer në të njëjtin muaj dhe i punësuarit kishte mbështetur 614 € të shpenzuara, me dokumentacion mbështetës përkatës. Kjo kishte lënë një balancë të papaguar prej 326 € që është dashur të kthehet në ZPK. Megjithatë që nga fundi i vitit, vetëm 131 € janë kthyer duke lënë ende një shumë prej 198 € të pakthyer në ZPK.

Konkluzioni

Nuk është bërë mbyllja e avanseve me kohën e duhur sipas “Rregulla financiare 02 e Thesarit” pika 9.1-Pagesat për avans.

#### Rekomandimi Nr. 4

ZPK duhet të zbatoj procedurë për të siguruar që të gjitha avanset për udhëtim janë të mbyllura dhe që çdo shumë e avanseve të pambyllura të kthehet brenda dy javësh nga përfundimi i udhëtimit.

#### 5. Prokurimi

Nga lista e prokurimit kemi zgjedhur 11 mostra për auditim dhe kemi gjetur shkelje serioze përgjatë procesit të prokurimit.

Shembuj të këtyre shkeljeve përfshijnë:

- Dy shpërblime kontratash (**E para** për furnizim të shërbime (kompjuterë, printerë, tonerë dhe USB-4GB dhe **e dyta** për publikime të aktiviteteve për media për nevojat e ZPK), me datë 21.07.07, që në total arrijnë vlerën për afërsisht 13,000 Euro

Të gjithë dokumentet e prokurimit (shpallja, hapja e ofertave, shpërblimi i kontratës, fatura dhe pagesa) kishin të njëjtën datë - 21.12.07.

Kjo do të ishte e pamundur nëse do të aplikoheshin procedurat e prokurimit në mënyrë adekuate.

Për më shumë, për njëzën nga këto kontrata, i njëjti zyrtarë i ZPK-së kishte kërkuar të bëhej prokurimi, kishte marrë pjesë në hapjen e ofertave, në vlerësimin e ofertave dhe kishte nënshkruar për mallrat e kontraktuara.

- Kontrata për furnizim me mobile e shpërblyer më 18.12.07 në një shumë totale prej 2,962.31 €.

Data e shpërblimit të kontratës ishte më e hershme se dita e regjistruar e hapjes së ofertave (20.12.07).

Për më tepër, komisioni i njëjtë kishte bërë hapjen dhe po ashtu vlerësimin e ofertave, që është në kundërtënie të drejtpërdrejtë me ligjin dhe rregullat e prokurimit.

Dy nga tre ofertuesit kishin ofruar dokumentacion të pakompletuar, gjë që është dashur të anulohet procedurat e prokurimit.

Fare në fund, kontraktori ishte paguar më 21.12.07, një ditë pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

- Për kontratën në vlerë 10,000 € të shpërblyer më 09.10.07 për blerjen e telefonave mobil

Asnjëra nga katër kompanitë që kishin ofertuar për këtë kontratë, nuk kishin siguruar dokumentacionin e kërkuar. Kjo do të përbënte bazë të mjaftueshme për të ndaluar prokurimin ( ritenderuar), megjithatë ZPK kishte vazhduar me prokurimin.

Në kundërtënie të drejtpërdrejtë me rregulloret e prokurimit, komisioni i njëjtë kishte hapur dhe vlerësuar ofertat.

- Ne kemi gjetur se pagesat e bëra për katër kontratat e rishikuara, kishin tejkaluar shumën nga kontrata origjinale.

ZPK kishte shpërblyer një kontratë për mallra dhe shërbime më 18.05.07 me një vlerë totale prej 2,760 €. Ne kemi gjetur se gjashtë pagesa ishin kryer në emër të kësaj kontrate që arrinin shumën totale prej 11,045 € ose për më shumë se 8,285.97 € mbi vlerën e kontratës.

ZPK kishte shpërblyer një tjetër kontratë më 05.07.07 në një vlerë totale prej 10,000 Euro për mirëmbajtjen e automjeteve Chevrolet. ZPK kishte bërë pagesa që tejkalonin vlerën e kontraktuar për 1,126 €. Po ashtu, në këtë automjet ishte kryer punë që nuk ishte e specifikuar në kontratë.

Krejt në fund, ne kemi gjetur se ZPK nuk kishte përgatitur planin final të prokurimit siç kërkohet me Ligjin mbi Prokurimin Publik.

## **Konkluzion**

ZPK ka kontroll të brendshme joadekuante dhe të dobët për të menaxhuar procesin e vet të prokurimit, duke rritur në këtë mënyrë ekspozimin ndaj mashtrimit, humbjes dhe shpërdorimit të parasë dhe pasurisë publike.

Ne kemi zbuluar shkelje serioze të ligjit të prokurimit, për të gjitha prokurimet që kemi rishikuar. Rrjedhimisht, ne do të nxisnim ZPK-në që të ndërmerr veprime të menjëhershme për të siguruar që kontrollet e saj të brendshme janë forcuar aq sa plotësisht të përkohet me pritjet e Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe me rregulloret e tjera të rëndësishme të prokurimit.

### **Rekomandimi Nr. 5**

ZPK duhet të zbatoj politikat dhe procedurat për të siguruar që veprimet e saj të prokurimit përkohet me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme të prokurimit. Politika dhe procedura të tilla do të përfshinin sigurimin që:

- Kontratat duhet të shpërblehen vetëm pasi të jenë aplikuar proceset përkatëse të tenderimit dhe vlerësimit të hapur;
- Të jenë formuar komisionet e ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e ofertave;
- Prokurimet janë anuluar aty ku ofertuesit nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar;
- Plani final i prokurimit, që kërkohet të përgatitet sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik, të jetë përgatitur,

ZPK duhet të zbatoj procedura për të siguruar që pagesat e bëra për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara, nuk tejkalojnë shumën e kontratës dhe janë vetëm për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në kontratë.

### **6. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)**

Njësia e Auditimit të Brendshëm ofron një aktivitet të pavarur, objektiv dhe këshillues, i ndërtuar në atë mënyrë që të rrisë vlerën dhe të përmirësoj funksionet e një organizate, në veçanti për sa i takon fushës së menaxhimit të rrezikut, kontrollës dhe proceseve udhëheqëse.

ZPK e ka të themeluar NJAB me një auditor i cili njëkohësisht është edhe Shef i Njesisë. Auditori është ekonomist i diplomuar, por nuk është kontabilist i licencuar apo i certifikuar. Auditori posedon disa certifikata që dëshmojnë se ai ka ndjekur disa trajnime mbi auditimin e brendshëm.

Në vitin 2007, NJAB kishte lëshuar dy raporte me një numër të gjeturash dhe rekomandimesh. Derisa cilësia e auditimeve po përmirësohet, ato nuk janë duke u planifikuar duke shfrytëzuar qasjen e bazuar në rrezikshmëri, që do të ndihmonte auditorin të vendos aktivitetet sipas përparësisë.

## Konkluzioni

Është një zhvillim pozitiv që ZPK ka themeluar NJAB. Brenda kufizimeve të veta të burimeve njerëzore, kjo njësi është duke përmbushur mandatin në mënyrë adekuate. Megjithatë, përmirësime do mund të bëheshin përmes planifikimit të auditimit sipas qasjes së bazuar në rrezikshmëri.

### **Rekomandimi Nr. 6**

Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet një herë në vit të kryej vlerësimin e rrezikshmërisë për aktivitetet e ZPK-së, për të identifikuar fushat me rrezikshmëri të lartë dhe për të zhvilluar një plan vjetor auditimi, në mënyrë që të trajtoj këto fusha me rrezikshmëri të lartë.

### **7. Menaxhimi i Pasurisë**

Gjatë auditimit të menaxhimit të pasurisë në ZPK, ne kemi rishikuar regjistrin e pasurisë dhe operacionet e sektorit të logjistikës përgjegjës për pranimin, ruajtjen, shpërndarjen, riparimin dhe shlyerjen e pasurisë.

Ne gjetëm se pasuria në përgjithësi është e regjistruar në harmoni me Udhëzimin Administrativ 2005/11.

Megjithatë, gjendja aktuale mund të përmirësohet përmes:

- Procedurave të përmirësuara të regjistrimit, për të siguruar që e gjithë pasuria në mënyrën e duhur është e pajisur me bar kode, e klasifikuar si duhet ose që ato të mos jenë pajisur me të njëjtin numër të bar kodit.

Ne kemi gjetur se nga 17 kompjuterë laptop pa bar-kode, dy nuk ishin kthyer nga anëtarët e stafit të cilët kishin ndërprerë marrëdhënien e punës me ZPK-n. Vlera financiare e këtyre laptopëve nuk ishte e regjistruar në regjistrin e pasurisë.

ZPK nuk kishte kryer inventarizimin e kërkuar të fund-vitit dhe as që kishte regjistruar vlerën e pasurisë së saj.

### **Rekomandimi Nr. 7**

Përmirësime në sistemin kontrollit të brendshëm për sa i takon pasurisë dhe regjistrimit të saj në regjistrin e kontabilitetit dhe në atë të pasurisë, mund të bëhen përmes zbatimit të plotë nga ana e ZPK-së të Udhëzimit Administrativ 2005/11 mbi Regjistrimin e Pasurisë Qeveritare. Po ashtu të bëjë kthimin e atyre dy laptopëve në ZPK sa ma par që të jetë e mundur dhe identifikimin e të tjerëve me bar-kode. Të behet regjistrimi i pasurive me vlerat e tyre financiare.

## **VIII. KOMENTET E ZYRES SE PRESIDENTIT**

ZP iu ka dhënë mundësia për dhënien e komenteve ne draft raportin e auditimit në mënyrë që të eliminohet rreziku i keqinterpretimit dhe keqkuptimit në mes te auditorëve dhe entitetit të audituar .

ZP ka bërë komentet e saja dhe ato janë përfshirë në këtë raport .

ZP nuk është pajtuar me disa nga të gjeturat tona ,por komentet e tyre nuk japin dëshmi në mënyrë që të ndikon në ndryshimin e opinionit të dhanun nga auditori.



OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL ZRYRA E AUDITORIT GJENERAL		
Date: 31.07.2008		
Classification	Year:	Reg. nr.
2007-07	2008	332



REPUBLIKA E KOSOVES - ZYRA E PRESIDENTIT  
 REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT  
 REPUBLIKA KOSOVA - URED PREDSEDNIKA

Datë:	31.07.2008
Për:	Zyra e Auditorit Gjeneral
Nga:	Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
Tema:	Komente rreth Draft Raportit "Auditimi i Pasqyrave Financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës" për vitin e përfunduar me 31.12.2007

E nderuara **Zyra e Auditorit Gjeneral,**

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK) ka pranuar draft raportin e juaj me datë 18.07.2008.

Draft raportin, e kemi lexuar dhe studiuar me vëmendje dhe kemi konstatuar se janë bërë disa lëshime nga ana e juaj, në përmbledhje të prezantimit të fakteve të testeve të bëra, e të prezantuara në raport.

Ne gëzojmë të drejtën e kundërshtimeve të disa të dhënave, të cilat janë përfshirë gabimisht në draft raport, për disa procese që ndërlidhen me pasqyrim të vërtetë dhe të drejte të shpenzimeve të paguara, të prezantuara në Pasqyrat Financiare, por edhe për disa procese tjera, si të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe të Menaxhimit të Pasurisë. Kopjet e këtyre të dhënave-dokumenteve që do t'i prezantojmë, le të jenë të krahasueshme me ato që ju i keni në dosje të auditimit.

Duke lexuar me vëmendje komentet tona dhe duke i analizuar dokumentet- kopje, mbështetëse, që do të ju dërgojmë, por duke pasur në konsideratë edhe specifikat e punës që duhet kryer në ZPRK, konsiderojmë se draft raporti i juaj auditues do të ndryshojë rreth keqkuptimeve apo gabimeve faktike, por, edhe në terminologji.

Komentet tona, në lidhje me kundërshtimet dhe pajtueshmërinë e draft raportit auditues, do t'i rendisim sipas të gjeturave tuaja.

Me qëllim të ruajtjes së vlerave dhe parimeve audituese, si dhe transparencës në opinionin publik, ne kërkojmë që komentet tona së bashku me kopjet e dokumenteve shtesë që po ju dërgojmë, t'i merrni në konsideratë.

Me respekt, Fahri Breznic



## Komentet e Zyrës së Presidentit dhe përgjigjejet e ZAGJ

Referenca	Komentet nga ZPRK	Komentet e ZRGJ-së
1.	<p><b>1. Pasqyrat Financiare</b></p> <p>Pasqyrat Financiare në ZPRK, janë përgatitur sipas regjistrave kontabël të bazuar në formën manuale të këtij regjistri, të cilat kanë qenë të harmonizuara për çdo tremujor, me të dhënat e Thesarit (SIMFK).</p> <p>ZPRK, ka përdorë njëkohësisht edhe një formë elektronike, jo sipas kodeve analitike, por, të ashtuquajtur regjistra sintetik.</p>	<p>Duke u bazuar në pasqyrave financiare dhe shënimeve të juaja të ofruara në formën elektronike vërehen diferencat nëpër kodet ekonomike, siç janë përmendur në piken VII. 1. të këtij raporti, andaj konstatimet e ZRGJ-së mbesin.</p>
